

## Kanada 2015/ Kombetarja e femrave nis me humbje eliminatorit

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 21 Shtator 2013 22:14

---



Kombetarja Shqiptare e futbollit per femra duket se nuk e ka nisur me kembe te mbare fazen e eliminatorëve per boterorin e “Kanada 2015”. Shqiptaret jane mposhtur me rezultatin 2-0 kunder Belgjikes. Vajzat shqiptare kaluan ne epersi qe ne minuten e 17-te te takimit kur pas nje goditje nga kendi, Philtjens ka shenuar porten kuq e zi. Vendaset gjate gjithe pjeses se pare te lojes kane tentuar qe me sulmin e tyre te godisnin serish porten. Disa minuta pas fillimit te pjeses se dyte , Zeeler ka shenuar dhe golin e dyte per belget nga pika e penalltise, pasi Gjyli kishte shkaktuar nje nderhyrje ne zone. Kjo ndeshje ishte e nje rëndesie te vecante per perfaqesuesen shqiptare pasi luante per here te pare ne nje kompeticion te tille. Ndeshja eshte ndjekur me interes dhe nga tifozet e ndryshem shqiptare. Takimi i rradhes pritet te zhvillohet me 26 tetor ne Tirane perballe Hollandes